



Motivimet orientaliste: Një studim mbi subjektivizmin

Description

Muhammad Mustafa al-Azami

Fragment i shkëputur nga libri i Muhammad Mustafa el-Azami me titull: *The History of the Quranic Text, from Revelation to Compilation: A Comparative Study with the Old and New Testament*; botime UK Islamic Academy, 2003

Pavarësisht gjithë prirjeve të tij kundër traditës islame, studimi perëndimor këmbëngul se po i kryen një shërbim myslimanëve, duke u ofruar atyre kërkim shkencor të pastër, asnjans dhe objektiv. Kjo sepse një dijetar mysliman, i verbuar nga feja, nuk mund të dallojë dot të drejtën nga e shtrembra, kur analizon besimin e vet[1]. Nëse këtu ka diçka të vërtetë, atëherë të paktën ne duhet të shqyrtojmë vetë Orientalizmin në lidhje me bestytnitë e veta dhe parimet bazë, pasi të damkosësh një grup si të anshëm, nuk e justifikon automatikisht deklarin për objektivitet të një grupi tjetër. Ekzaminimi i rrënjëve të Orientalizmit të detyron të gërmosh në politikën e shkuar dhe të tashme, për të kuptuar disa motivet e tij, në mënyrë që lexuesi të peshojë më mirë kërkimin perëndimor në lidhje me Kur'anin.

1. Analogjia për hebrejtë

Para se të diskutojmë Orientalizmin le të ngremë një pyetje të ngjashme: sipas opinionit hebre, a mundet një dijetar anti-semit të japë mendim të paanshëm, kur ekzaminon dokumentet hebreje si Dhiata e Vjetër apo Dorëshkrimet e Detit të Vdekur? Çfarëdolloj përgjigjeje të marrim, pozitive apo negative, duhet ta aplikojmë atë dhe ndaj objektivitetit të supozuar të orientalistëve në shqyrtimin e tyre të Islamit.

i. Vlefshmëria e veprave anti-semite

Friedrich Delitzsch, studiues i krishterë dhe një prej themeluesve të Asiriologjisë, vinte nga një traditë e shquar studiuesish të Dhiatës së Vjetër dhe ishte pjesërisht me origjinë çifute[2]. Megjithatë këndvështrimi i tij ndaj Dhiatës së Vjetër ishte çuditërisht jomiqësor:

Dhiata e Vjetër është e mbushur me të gjitha llojet e mashtrimeve, një mishmash i vërtetë figurash të pasakta, të pabesueshme, të paqëndrueshme, përfshirë ato të kronologjisë biblike, një labirint i vërtetë portretesh të rremë, përsëritjesh, inspektimesh dhe shkëmbimesh çorientuese, përzier e gjithë kjo me anakronizëm. Është një lëmsh i pafund detajesh dhe tregimesh kontradiktore, trillimesh, legjendash dhe përrallash. Me pak fjalë, është një libër plot me mashtrime të qëllimshme dhe të paqëllimshme, pjesërisht vetë-mashtrues, një libër shumë i rrezikshëm, përdorimi i të cilit nevojit kujdesin më të madh[3].

Shumë shpesh është akuzuar për antisemit dhe Delizsh po kaq shpesh e ka mohuar atë.

Por në lidhje me disa shënime të tij (si p.sh., kur ai i quan çifutët ‘një rrezik i frikshëm, për të cilët gjermanët duhet të kenë kujdes’), akuzat duket se janë të justifikueshme[4].

Mbi veprën “Die Grosse Täuschung” të Delizsh, *John Bright* shkruan se:

Prallëherë ka ndodhur që Dhiata e Vjetër të ketë qenë subjekt i abuzimeve keqdashëse si në këtë libër. Është vërtetë një libër shumë i keq (do të thoja, ‘një libër që të pështiros’)[5].

Shfaqja haptazi e armiqësisë ndaj Dhiatës së Vjetër dhe dëshira e tij e fortë për të ndarë Krishterimin prej saj, bëri që libri i Delizsh të refuzohej dhe reputacioni i tij të lëkundej seriozisht si pasojë e antisemitizmit.

1. A mund të jetë i paanshëm një studiues anti-hebre,

kur ai studion një çështje në lidhje me Hebraizmin?

John Strugnell, profesor i Harvardit, u ngrit në detyrën e kryeredaktorit të ekipit zyrtar botues të Dorëshkrimeve të Detit të Vdekur në vitin 1987, por tri vjet më vonë u pushua nga posti në një mënyrë mjaft publike. Problemet e tij filluan me një intervistë të lëshuar gazetarit izraelit Avi Katzman (botuar në *Ha’aretz* më 9 nëntor 1990), në të cilën ai, jo vetëm u duk se vuante nga depresioni-maniak, por dhe shprehu ndjenja anti-hebreje. Ndër të tjera, shprehje mjaft pikante ishte cilësimi i tij i hebraizmit si “një fe e tmerrshme”, se problemi i hebrejve mund të zgjidhej në mënyrën më të mirë nëpërmjet një konvertimi në masë në Krishterim dhe se Hebraizmi në thelb është racist. Edhe pse ai në fillim të intervistës deklaroi se nuk dëshironte që komentet e tij të konsideroheshin si anti-semite, Katzman e injoroi tërësisht këtë kërkesë dhe e kritikoi atë qartazi. Strugnell dyshoi se,

pas z. Katzman qëndron shqetësimi, nëse studiuesit e krishterë do të mund të trajtojnë në mënyrë të paanshme natyrën e dorëshkrimeve, duke qenë se janë dokumente të një sekti hebre... Jam i mahnitur, ndërsa dëgjoj njerëz si *Schiffman* [të Universitetit të Nju Jorkut] të thonë se sa e trishtueshme është që studiuesit hebrej të mos kenë punuar mbi këto tekste[6].

Si pasojë e goditjes së artikullit, ai u shkarkua nga detyra. Vite më vonë ai vazhdoi t’i mohonte prirjet e tij anti-semite, duke këmbëngulur madje në përdorimin e termit ‘anti-hebre’ (person jo antagonist ndaj hebrejve si individë apo masa, por vetëm ndaj Hebraizmit si fe).

Nuk merrem me faktin a më pëlqen apo jo feja hebreje. Dua të arrihet më tepër për fenë e Krishterë. Dua që mbretëria e Krishtit të jetë më e lavdishme, gjë që patjetër mund të arrihej me 20 milion hebrenjtë e konvertuar[7].

Edhe pse prof. Strugnell ishte i krishterë, ai duhet të ketë përfutur kuptimin teologjik të Dorëshkrimeve të Detit të Vdekur, përndryshe posti i kryeredaktorit do të kishte qenë një ëndërr e pashpresë. Pushimi i tij nga puna nuk ishte si pasojë e paaftësisë, apo e mosbesimit, apo denigrimit të dorëshkrimeve që ai mbikëqyri. Siç vërejtë dhe ai vetë, dukej se ishte tërësisht frikë e hebrevje ndaj subjektivizmit të tij në ekzaminimin e dokumenteve me natyrë hebreje, si dhe nga entuziazmi i tij për Krishtin. Ky rivalitet fetar krijoi kushtet e mjaftueshme për heqjen e tij, pavarësisht aftësive në këtë fushë.

iii. Janë të lirë studiuesit hebrenj të trajtojnë çështje hebreje?

Deri tani kemi përmendur dy raste, ku akuzat për antisemitizëm penguan studiues të shkëlqyer të bëjnë punë kërkimore në lidhje me çështje hebreje. Po vetë studiuesit e shkëlqyer hebrenj, a mund të konsiderohen ata të kualifikuar në studimin e materialeve disi delikate?

Dorëshkrimet e Detit të Vdekur janë zbuluar që nga viti 1947. Edhe pse ekipi redaktues përfundoi një transkriptim të të gjithë tekstit deri në fund të viteve '50 (përfshirë dhe një marrëveshje të plotë), ata ruajtën të fshehtë, jo vetëm dorëshkrimet, po edhe ekzistencën e tyre. Duke e marrë shtruar, ekipit iu desh të punonte afro dyzet vjet për të botuar gati 20% të tekstit. Hershel Shanks, kryeredaktor i Revistës së Arkeologjisë Biblike (*Biblical Archaeology Review*) mbajti pezull drejtorin e Departamentit të Antikiteteve Izraelite (IAD) për më shumë se 25 vjet më vonë në kërkim të kësaj marrëveshjeje, vetëm që drejtori ta siguronte se nuk kishte dijeni për të[8]. Ndërkohë që qarqet akademike prisnin me ngulm një kopje të teksteve të pabotuara, ato gjetën vetëm një vendosmëri të akullt, të panështruar nga ana e botuesve të dorëshkrimit, për të pasur kontroll ekskluziv të të gjitha gjetjeve[9].

I gjetur përballë kritikave të vazhdueshme Gjenerali Amir Drori, drejtor i IAD, lëshoi një deklaratë për shtyp në shtator të vitit 1991, në të cilën garantonte akses më të lirë ndaj fotografive të Dorëshkrimeve[10].

Gjeneral Drori tha se nëse teksti mund të shihet nga çdokush, atëherë do të rrezikohej “*interpretimi i saktë*”... Ia vlen të detajohen përpjekjet e fuqishme të hershme të marrëveshjes për të ruajtur sekretin e teksteve të pabotuara. Këto përpjekje u shoqëruan nga një përbuzje ndaj ndokujt, që guxonte të vinte në dyshim urtësinë e asaj marrëveshjeje[11].

Eugene Ulrich i Notre Dame, ndër redaktuesit e ekipit, protestoi që “redaktimi i dorëshkrimeve ka hequr keq, jo nga vonesa, por nga nxitimi i tepruar”[12]. Profesorët e universiteteve nuk mund të vlerësonin me kompetencë përpjekjet e ekipit për të cilat ai këmbëngulte, duke i bërë jehonë ndjesisë së vazhduar të ekipit, që vetëm redaktorët zyrtarë dhe studentët e tyre ishin të përshtatshëm për këtë punë.

“Në një intervistë të *Scientific American*, kryeredaktori pohoi se Oxford don Geza Vermes nuk ishte ‘kompetent’ në ekzaminimin e dorëshkrimeve të pabotuara, pasi Vernes nuk pati bërë punë serioze. Vernes është autor i mjaft librave të shquar mbi Dorëshkrimet e Detit të Vdekur, përfshirë botimin e tretë të “Dorëshkrimet e Detit të Vdekur në gjuhën angleze” të botimeve *Penguin*. Intervistuesi i *Scientific American* u tregua dyshues: “Një profesor në Oksford, i paaftë?” Kështu kemi qenë.”[13]

Dyshimi këtu është i bazuar, pasi çështja e vërtetë këtu nuk është aftësia, po dëshira për të vënë një vijë mbi 'interpretimin përfundimtar'. Duke e ndjekur këtë skemë nga fillimi dhe duke ruajtur me fanatizëm Dorëshkrimet nga akademia në përgjithësi, ekipi nuk pranoi apo njohu ndonjë lloj studimi, hebre apo jo, përveç atyre që ndihmonte për ndonjë qëllim të caktuar. A mund të ketë shembull më të qartë të subjektivitetit të rrënjësor?[14]

Këto tri shembuj dhe shumë të tjerë nga Europa e pasluftës dhe Amerika, ilustrojnë një temë të vazhdueshme të zhdukjes së të gjithë studiuesve (nëse gjallë, fizikisht, nëse të vdekur, akademikisht), që shfaqnin rivalitet ideologjik në rrjedhën e punës në çështje hebreje. Nuk kishte rëndësi nëse këta studiues ishin gjoja të famshëm apo të famshëm. E vetmja gjë që shihej në skualifikimin e tyre ishte papërputhshmëria ideologjike. Po për myslimanët, deri ku qëndron kjo mënyrë mendimi?

2. Sfondi për myslimanët

i. Shtypja izraelite e historisë së Palestinës

Keith Whitlam, profesor i Studimeve Fetare të Universitetit të Stirling (Skoci) është autor i një artikulli, që ngjalli mjaft debat në shumë qarqe biblike, ku thuhej se ishte një konspiracion i studiuesve biblikë dhe arkeologëve, veçanërisht sionistëve, që tentonte t'i jepte një formë të tillë historisë së hebrenjve, e cila mohonte historinë e atyre që ishin vendosur aty shumë kohë përpara izraelitëve, palestinezëve[15]. Që nga viti 1948, qëndrimi i studiuesve izraelitë, deklaroi ai, ka qenë vendosja e një të shkuare, e cila nga njëra anë madhëron pretendimin për tokën nga ana e izraelitëve të hershëm dhe nga ana tjetër zhvlerëson dhe zhvendos të gjitha historitë dhe kulturat vendase[16]. Kështu, studiuesit e Biblës synojnë t'i privojnë tokën palestinezëve në të tashmen, duke ia privuar atyre në të shkuarën.

Studimet biblike kanë qenë pjesë e strukturës komplekse të fuqisë akademike, ekonomike dhe ushtarake, me të cilën palestinezëve u është mohuar një prani apo histori bashkëkohore[17].

Duke refuzuar këndvështrimet e tij, Hershel Shanks citon kulturat e shumta jo-izraelite në atë zonë, që kanë parë së fundmi një ringjallje akademike: filistinët, edomitët, moabitët, arameanët, hurrianët, kananitët. Ai akuzon *Whitlam* për politizim të historisë dhe përfundon duke thënë se, ndërkohë që studiuesit pro-sionistë janë përpjekur t'i largohen tutje subjektivizmit të viteve të shkuara, kjo nuk është e vërtetë për *Keith Whitlam*[18].

Gjatë leximit të kësaj reviste, mbeta i goditur pasi Hershel Shanks nuk i referohet kurrkund historisë islame apo ndonjë ringjalljeje të ngjashme akademike. A nuk është kjo shpërfillje e rastësishme "pjesë e strukturës komplekse", me anë të së cilës *Whitlam* i sheh palestinezët si popull që i është mohuar autoriteti dhe toka që u takon? Cila kulturë, kananite apo myslimane, përkufizon më mirë vetë-identitetin palestinez dhe pse ky neglizhohet tërësisht? Edhe pse në fund ai është përgatitur të njohë zakonet dhe kulturën e hershme palestineze, Shanks sidoqoftë duket se nuk ka shumë dëshirë t'i japë fesë së tyre vendin që i takon në historinë e tokës. Duket sikur në ngushtimin e këndvështrimit të tyre vetëm në studimet antike, studiuesit izraelitë dhe perëndimorë i shohin 14 shekujt e kulturës myslimane si piring mbeturinash që duhet ta gërmojnë me lopatë derisa të arrijnë tek ajo që u intereson më shumë.

1. Pionier i orientalistëve dhe mashtrues i myslimanëve

Le t'i kthehemi Orientalizmit duke marrë në studim një rast tjetër. Në veprën e tij "Origjina e Jurisprudencës Muhamedane", Shaht shkruan se:

Ndjej detyrim të thellë ndaj zotëruesve të studimeve islame të brezave të fundit. Emri i *Snouck Hurgronje* shfaqet rrallë në këtë libër, por, nëse ne e kuptojmë tani karakterin e Ligjit Muhamedan, kjo është falë tij[19].

Por kush ishte *Snouck Hurgronje*? Një orientalist, qëllimi i të cilit ishte të mashtronte masat e myslimanëve të Indonezisë në pranimin e ndërhyrjes kolonialiste të qeverisë gjermane: "Islami është feja e paqes", predikoi ai. "Detyra e myslimanëve, sipas Sheriatit, është të ndjekin urdhrat e udhëheqësve (gjermanë) – dhe jo të ngrenë krye apo të bëjnë akte dhune"[20]. Duke udhëtuar drejt Mekës për të thëlluar më tej këtë magjepsje, ai shpalli veten mysliman për të fituar më shumë popullaritet, pa sakrifikuar qëllimin e plotë të ambicieve të tij. Eduard Said thotë se: "bashkëveprimi i ngushtë mes dijetarëve dhe pushtimit kolonial ushtarak të drejtpërdrejtë" gjen zbatim në "rastin e orientalistit të nderuar gjerman C. *Snouck Hurgronje*, i cili përdori mirëbesimin që pat fituar nga myslimanët për të planifikuar dhe ekzekutuar luftën brutale gjermane kundër popullit të Sumatrës"[21].

Dhe pas gjithë kësaj, ai konsiderohet si pionier perëndimor i ligjit islamik. Çështja është e qartë. Ndërkohë që, të akuzuarit për vërejtje jo të favorshme kundrejt Hebraizmit gjykohen haptazi, izolohen dhe mbahen larg, vetë anëtarët e inteligjencës çifute, që dënojnë paragjykimet e Strugnell, janë të plogët ndaj fanatizmit izraelit kundër kulturës dhe veprave myslimane. Ndërkohë paragjykimi shumë më i madh i *Hurgronje* dhe agjentëve të tjerë kolonialistë, që shfaqet jo vetëm me fjalë, por edhe me shkatërrim dhe nënshtrim ushtarak të drejtpërdrejtë, në përgjithësi nuk vihet re dhe statusi i tyre në sferat perëndimore, si "pionierë të orientalizmit", mbetet i paprekur.

3. Në kërkim të paanësisë

i. Një perspektivë historike: çifutët, të krishterët dhe romakët

I gjithë studimi mbi orientalizmin është ndërtuar mbi premisën e të huajit më të ndritur, i cili është tërësisht i paanshëm. Por, a i ka lënë ndonjëherë vend tradita perëndimore ose judeo-e krishterë këtij objektiviteti të supozuar? Ku janë këta xhevahire të ligjëratave të mençura në katalogun subjektiv dhe vulgar të shkrimeve historike perëndimore? Them vulgar, pasi askush nuk mund të krahasojë nderimin me të cilin myslimanët trajtojnë Jezusin, Virgjëreshën Maria, Moisiun, Aronin, Isakun, Abrahamin, Davidin, Solomonin, Lotin, etj, me britmat e ashpra dhe të tërbuara të çifutëve kundër të krishterëve, të të krishterëve kundër çifutëve, të katolikëve kundër protestantëve, të romakëve të lashtë kundër çdokujt tjetër. Më poshtë do të citoj gjatë Adrian Riland, profesor i Gjuhëve Orientale në Universitetin e Utreht, i cili në vitin 1705 shkroi një vepër unike në latinisht, që më pas u përkthye dhe u botua në Londër me titull "Katër traktate në lidhje me doktrinën, disiplinën dhe adhurimin e mahometanëve" (1712).

Populli çifut, edhe pse kishte institucionet dhe ligjet më të shenjta që mund të kenë zbritur, nuk i shpëtoi dot zemërimit të njerëzve të lig, të cilët hodhën shumë baltë mbi ta pa asnjë farë të drejte. Vetë *Tacitus*, që nuk donte mundësi këshillimi të hebregjeve në çështjet e tyre, shkruan se ata u përzunë nga Egjipti për shkak të thyerjes së tyre dhe se shenjtëruan imazhin e një gomari, që i mësoi atyre si të heqin Etjen dhe që të pushojnë së enduri. *Plutarku* thotë se Festa e Tabernakullit është për nder të *Bakusit*. Jo vetëm kaq, por dhe Sabathi u shenjtërua kështu. *Rutiliusi* i quan sabathët hebrej si

sabathë të ftohtë dhe pati thënë se zemra e tyre është më e ftohtë se feja e tyre. Kjo është arsyeja pse shumë prej çifutëve nuk e ndezin zjarrin ditën e Sabbathit[22].

Po kur të krishterët braktisën çifutët dhe ngritën një mënyrë të re adhurimi, ç'ndodhi? Ç'përfaqësim i keq iu bë fesë sonë nga barbarët! Ata ia ngarkuan çdo gjë të krishterëve, duke thënë se Zoti i tyre ishte një thundrak si gomari, se ata adhuronin gjenitalet e një prifti, se ata kënaqeshin me një fëmijë të vogël të mbuluar me lule, se, pasi mbaronin festat e tyre solemne, burrat dhe gratë përqaфонin njëri-tjetri si t'i udhëzonte rastësia dhe se ata kërcënojnë shkatërrimin e gjithë botës nga Zjarri, ...thelbi i doktrinës së adhurimit që Zoti i shtroi atyre nën shenjën e ateizmit. Përmbledhja e gjithë fjalëve të Tertulit gjendet në Apologjinë e tij: "*Ata konsideroheshin vrasës, fajtorë për incest, sakrilegj, ishin armiq publikë të njerëzimit, fajtorë të të gjitha të këqijave dhe rrjedhimisht armiq të Zotit, të mbretërve, të moralit dhe të natyrës universale*"[23].

Por, nëse e zhvendosim mendimin deri në kohët tona, do të gjejmë se njerëzimi nuk është aspak larg gjithë këtyre. Po atëherë, me çfarë nuk na ngarkoi Kisha e Romës, kur ne u ndamë prej saj? Ata pohojnë në Librat e tyre se ne vepra të mira i konsiderojmë neveritëse, se ne afirmojmë se Zoti është autor i të keqes, se ne përçmojmë Marinë, Krishtin dhe kujtimin e të shenjtëve, se ne jemi ndarë në njëqind e njëzet e gjashtë sekte të neveritshme, emrat e të cilëve nuk mund të lexohen pa qeshur, se Luteri bisedonte nga afër me Djallin dhe i dha fund me varje jetës së tij, se Kalvini ishte fajtor për shumë të këqija dhe vdiq në fshehtësi nga ulcera, se emri i Luterit, në hebraisht *Lulter*, shpreh numrin e Antikrishtit 666, se ai do të sillte mbretërinë e *Mahomet*-it nga këto anë dhe se ministrat dhe ndjekësit e tij do të binin shumë shpejt në *Mahometanizëm*[24].

Sigurisht që, nëse ka pasur ndonjë fe që është keqpërdorur nga kundërshtarët, qoftë dhe me përbuzje, dhe që është menduar në mënyrë të pamërituar të refuzohet, ka qenë pikërisht kjo (Islami). Nëse dikush modelon një doktrinë të neveritshme, e quan atë muhamedane. Është sikur të mos ketë asgjë të mirë në besimin *muhamedan*, ku çdo rregull është i korruptuar. Nuk kemi pse merremi me këtë, meqenëse ekziston marrëveshja më e madhe ndërmjet Djallit dhe *Mahometit*, siç ka treguar me anë të argumenteve të shumta autori i "*Fjala e katërt kundër Mahometit*"... Nëse ndokush nga të rinjtë tanë dëshiron të fillojë Studimin e Teologjisë dhe është i etur që të kuptojë fenë *Mahometane*, le të vazhdojë [të studiojë trajtesat e bëra nga autorët perëndimorë, që shkruajnë pa pasur njohuri]. *Nuk këshillohet të mësojë arabishten, të dëgjojë fjalët e Mahometit në gjuhën e tij, të marrë shkrimet Lindore dhe të shohë me sytë e tij, e jo me të njerëzve të tjerë. Kjo sepse, nuk ia vlen të harxhohet aq mund dhe lodhje, vetëm për të kuptuar Ëndrrat dhe Përçartjet e një fanatiku*[25].

Në një masë të madhe, ndjesitë e fundit janë të vërteta dhe për sot. Shkolla revizioniste këmbëngul se dokumentet mysliman nuk mund të duken të vërtetë, përsakohë që burime të tjera, jomyslimane, të provojnë vërtetësinë e tyre[26]. Duke parë sa egërsisht të krishterët dhe hebrenjtë kanë valëvitur flamurët kundër myslimanëve, që nga agimi i hershëm i Islamit, sa garanci mund të kemi ne për priftërinjtë dhe rabinët e Mesjetës, që të mund t'i kenë parë me objektivitet arritjet e rivalëve të tyre më të hidhur? Studiuesit perëndimorë vlerësojnë pa kushte abuzimet e pamasa, që hebrenjtë dhe të krishterët i bënë njëri-tjetrit, ku secili grup ngriti barrikadë nga injoranca dhe supersticioni i vet[27]. Atëherë, mbi ç'baza mund të konsiderohet i vërtetë abuzimi i tyre i pamasë kundër myslimanëve, i kurdisur ky nga e njëjta injorancë dhe supersticion[28]?

ii. Paanësia në studimet e sotme

Eduard Said, në librin e tij të ngjeshur dhe vizionar me titull *Covering Islam* (Shpjegim i Islamit),

eksponon sensacionalizmin politik dhe të udhëhequr nga media, që ushqen masat perëndimore me një pamje thellësisht të shtrembëruar të Islamit. I pakeluar si një rrezik shumë i madh i qytetërimit perëndimor, Islami ka fituar një reputacion të çuditshëm kërcënues, që nuk i afrohet asnjë grup tjetër fetar apo kulturor[29]. Ai shërben si një dash kurban i lehtë për t'u therur për çdo fenomen socio-politik ose ekonomik, që Perëndimi e sheh si të papranueshëm, ku konsensusi politik është që, edhe pse dihet shumë pak rreth këtij religjioni, nuk është se aty ka shumë për t'u parë me sy të mirë[30]. Ndërsa shkon në rrënjë të këtij antagonizmi, Saidi nënvizon tendencën historike të krishterë për ta parë Islamin si një cenim, një sfidë e re ndaj autoritetit të tyre, një armik mahnitës, i cili përgjatë Mesjetës:

besohej të ishte një religjion demoniak i apostazisë, blasfemisë dhe obskuritetit. Nuk dukej se kishte rëndësi, që myslimanët e konsideronin Muhamedin një profet dhe jo zot; ajo që kishte rëndësi për të krishterët, ishte që Muhamedi ishte një profet i rremë, një mbjellës i prishjes, ..., dora e djallit[31].

Edhe kur Europa e krishterë dëshmonte ngritjen e saj, si pasojë e qeverisjes së myslimanëve, kjo situatë e përkohshme frike dhe urrejtjeje vazhdoi; afërsia e tij e madhe me Europën, e bëri muhamedanizmin një kërcënim të heshtur, që nuk u zotërua kurrë në mënyrë të kënaqshme. India, Kina dhe kultura të tjera lindore, sapo u vunë nën zaptim, menjëherë sapo u nënshtruan, ngjanin të largëta dhe nuk ishte më i nevojshëm të kuptuarit konstant të qeverive dhe teologëve europianë. Vetëm Islami dukej se ruante pozitën e tij, ishte i pavarur me këmbëngulje dhe e shpërfillte nënshtrimin e plotë ndaj Perëndimit[32]. Ai vazhdon diskutimin duke pohuar me bindje, se në asnjë kohë në historinë europiane ose amerikane nuk ka ndodhur që Islami të "diskutohej në përgjithësi ose të mendohej jashtë një kornize të krijuar nga pasioni, paragjykimi dhe interesat politikë"[33]. Ndërkohë që Piteri i Nderuar, *Barthelemy d'Herbelot* dhe shkrimtarë të tjerë të hershëm ishin padyshim polemistë të krishterë, që vërvitnin në ajër sharje ndaj kësaj feje rivale, epoka jonë, në mënyrë të verbër, pranon që modernizmi ka pastruar Orientalizmin nga paragjykimet e tij, e ka çliruar atë, si kimisti, që analizon tani strukturën molekulare me saktësi, në vend që të të gjurmojë alkiminë.

A nuk ishte e vërtetë se *Silvestre de Sacy*, *Edward Lane*, *Ernest Renan*, *Hamilton Gibb* dhe *Louis Massignon* ishin studiues të ditur e objektivë dhe a nuk është e vërtetë që të ndjekësh në shekullin e 20-të sociologjinë, antropologjinë, linguistikën dhe historinë, do ndeshesh me studiuesit amerikanë që japin mësim mbi Lindjen e Mesme dhe Islamin në vende si Princeton, Harvard dhe Chicago? A janë ata të paanshëm dhe të çliruar nga deklarata të veçanta në detyrën që kryejnë? Përgjigja është "Jo!"[34]

Çdogjë rreth studimit të Islamit sot mbetet e fundosur në dobitë dhe presionet politike. Artikujt, përmbledhjet dhe librat kullojnë domethënie politike, edhe kur autorët e tyre propozojnë ndjenjat e tyre të sëmura nën një zhargon me "paanësi shkencore" dhe përdorin titujt e tyre universitarë për të treguar distancë nga çdo qëllim tjetër.[35]

4. Presionet dhe qëllimet

Teoritë orientaliste nuk kanë lindur në vakum, por në një botë nevojash të ngutshme politike, që shkrijnë dhe ngjyrosin gjithçka rreth tyre. Le të inspektojmë, se si këto nevoja me kalimin e kohës janë zhvendosur.

i. Kolonializmi dhe demoralizimi i myslimanëve

Që të kuptosh qëllimet perëndimore, është e nevojshme që të heqim një vijë përgjatë vitin 1948. Para

kësaj kohe mësymja kryesore ishte që Muhamedi të shfaqej si një profet i rremë, Kur'ani si amatoresk, hadithet si të rrema dhe Ligji islam si një sallatë e varfër e përshtatur nga shumë kultura. Me pak fjalë, duheshin gjetje, që dukej sikur demoralizonin myslimanët (veçanërisht klasat drejtuese, që kishin më të ngjarë të binin viktimë) dhe që ndihmonin forcat kolonizatore në korrijen e subjekteve të ndershëm, duke shtypur çdo nocion të historisë mbretëruese islame ose identitetin e shquar mysliman.

Duke qenë se pothuajse të gjitha territoret myslimane u shkatërruan nga një formë e kolonializmit, kalifati osman ra, ishte koha e duhur për një sulm të furishëm në punët e përditshme të njerëzve. Dijetarët e legjitimuar myslimanë, ulematë, u vunë nën shtrëngim ekstrem politik, pjesa më e madhe e ndihmave, një burim i pasur ky për dijen islame, u mor ose u konfiskua[36]. Ligji Islam u zhvendos dhe u shfuqizua. Gjuha e kolonizatorëve dhe shkrimi i tyre fitoi prioritet mbi gjithë të tjerët, urdhër ky që në mënyrë efektive bëri që kombe të tërë të ngecnin në analfabetizëm të institucionalizuar. Aftësia e tyre e kufizuar në gjuhët europiane i marxhinalizoi dhe më tej ulematë, përgjigjet që ata jepnin ndaj pyetjeve (fetvatë) ishin kryesisht në gjuhën e tyre amtare dhe kaluan pa u vënë re. Megjithatë Orientalizmi nuk ishte i interesuar të debatonte me ulematë, aq më tepër të dëgjonte kritikizmat e tyre, qëllimi i tij i vetëm ishte të përdorte burimet koloniale në bashkëpunim me ministritë e jashtme[37], për të influencuar brezin e ri të elitave myslimane të edukuara në Perëndim[38]. Duke i flakur këto elita në një turmë sekulariste dhe duke i bindur ata se besnikëria ndaj Kur'anit është e pavlerë, ata digjeshin nga dëshira për të gërryer gjithë perspektivat e tashme dhe të ardhme të forcës politike myslimane.

Pasi 'provuan' se tek Muhamedi ishin të gjitha veset dhe se të gjitha mënyrat vjedharake nga Shkrimet e Shenjta i gjeje tek Kur'ani, *Geiger*, *Tisdall* dhe të tjerë që ndihmuan në çimentimin e kësaj skeme, kthyen sytë nga sunneti i Profetit. Nderi për ta shkatërruar atë i takoi Goldziherit (1850-1921), orientalisti me rang më të lartë i kohës së tij. Sipas vlerësimit të prof. *Humphrey*, vepra e tij, *Muhamedanische Studien*:

demonstroi me sukses që një numër i madh hadithesh të pranuar dhe nga koleksionet më rigorozë kritike myslimane, ishin falsifikime të plota dhe vinin nga shekulli i 8-të ose 9-të (shek. i 1-rë ose i dytë), dhe si rrjedhim ato ishedet tepër të përpikta, në të cilat ato mbështeteshin, ishin tërësisht të rreme.[39]

Jozef Shaht e vazhdoi dhe më tej konkluzionin e udhëheqësit të tij: ishedet, sipas këndvështrimit të tij, ishte një mbeturinë e revolucionit abasit, në mesin e shekullit të dytë. Ishedet më perfektë ishin ata, që kishte më shumë të ngjarë të ishin të rreme. Aq shumë e vlerësuar ishte teoria e tij, sa që "Origjina e Jurisprudencës Muhamedane" u bë bibla e orientalistëve, për të cilin *Gibb* parashikoi që ky libër "do të bëhet themeli i të gjitha studimeve të ardhshme të qytetërimit dhe ligjit islam, të paktën në Perëndim"[40]. "Ne mund të vendosim thjesht që Shaht ka të drejtë", vazhdoi më tej *Humphreys*[41]. Studimi kritik i veprës së tij është lënë pas dore në mënyrë sistematike[42], madje është refuzuar. Kur kohë më vonë Amin el-Masri e zgjodhi veprën si subjekt për studim kritik në tezën e tij të Doktoraturës, Universiteti i Londrës e hodhi poshtë aplikimin e tij dhe e njëjta gjë i ndodhi dhe në Universitetin e Kembrixhit[43]. Profesor *N. J. Coulson* u përpoq të nxirrte me delikatesë disa nga dobësitë e tezës së Shahtit, megjithatë këmbëngulte që, në vija të përgjithshme, ajo ishte e pafuzueshme. Pak kohë më vonë ai u largua nga Universiteti i Oksfordit.

Vansbruh, sipas gjetjeve të Shahtit, doli në përfundimin se "me përjashtime të rralla, jurisprudenca islame nuk derivonte nga përmbajtja e Kur'anit". Kështu, statusi i Kur'anit në historinë e hershme islame u marxhinalizua edhe më tepër nga duart e Vansbruh, i cili e çrrënjosi atë pothuajse tërësisht nga çështjet e rëndësishme të komunitetit të myslimanëve. Ato pak raste të mbetura që mund të

përdoreshin si prova për derivimin e Kur'anit u eliminuan: "Mund të shtohet që ato pak raste të veçanta ... nuk janë domosdoshmërisht provë e ekzistencës së hershme të burimit të shkrimit". Për këtë ide përfundimtare ai parashtroi një referencë. Çdokush mund të pyesë veten sa punë kolosale ka përcaktuar ky pohim përgjithësues rreth Kur'anit, por fusnota shkruan: "*Strack, H., Introduction to the Talmud and Midrash*"[44]. Kjo do të thotë që, nëse nëse ka diçka të vërtetë në Talmud dhe në Midrash, atëherë kjo duhet të jetë edhe më e vërtetë në Kur'an.

ii. Çështja hebreje dhe fshirja e historisë. Ndërtimi i një historie të re

Kauzës së orientalistëve iu shtua dhe një impuls i ri që nga viti 1948: nevoja për të siguruar kufijtë dhe ambicjet rajonale të Izraelit. Për të studiuar këtë motiv të ri, na duhet të ekzaminojmë së pari "Çështjen hebreje". Brutaliteti i inkuizicionit spanjoll, i shkaktuar nga një komb, që pohonte se përfaqonte një Zot të dashur, rezultoi në "spastrimin" e gadishullit nga e gjithë prania myslimane si dhe në shpërhapjen e çifutëve. Nga këta çifutë, një pjesë u strehua në Turqi, nën mbrojtjen osmane, kurse të tjerë u vendosën nëpër Europë dhe patën një fat të papërcaktuar. Për shembull, çifutët e fillimshekullit të 19-të, me banim në Gjermani, nuk konsideroheshin ligjërisht njerëzorë. Ato ekzistonin si pronë private e mbretit.

Si shumë shërbëtorë të tjerë, çifutët nuk mund të lëviznin nga një qytet në tjetrin, të martoheshin apo të kishin më shumë se një fëmijë, pa marrë leje. Megjithatë, për shkak të lidhjeve të tyre ndërkombëtare, çifutët nxiteshin zyrtarisht për të qëndruar në Gjermani, me synim për të lehtësuar tregtinë[45].

Për gjermanët, çështja hebreje shfaqej si trazira e një kombi të krishterë, "si mënyra për të trajtuar një popull të tërë, që ishte i papërshtatshëm për të qenë të lirë"[46]. Nga të gjitha teoritë që u parashtroan duke dhënë zgjidhje të ndryshme, asnjë nuk ia kaloi ndikimit të Karl Marksit. Skema e tij e çlirimit të hebrenjve, ishte t'i çlironte ata nga identiteti i tyre fetar, ndërsa mbështeti edhe një peticion për të drejtat e çifutëve[47]. Denis Fishman shkruan:

Vërtetë, "në analizë të fundit, *emancipimi* i hebrenjve është çlirim i njerëzimit nga hebraizmi". Hebrenjtë, thotë Marksi, mund të jenë vërtetë të lirë, kur, si hebrenj, ata nuk do të ekzistojnë më.[48]

Termi "hebre" ka dy kuptime: (1) si komb dhe (2) si ndjekës të hebraizmit. Marksi dëshironte t'i çlirojë hebrenjtë nga ajo që ai sheh si influenca prangosëse e të djaveve. Sigurisht që, në rastin e tij, përqsja më e lehtë është t'i ndajë *gjithë* njerëzit nga kombësia e tyre, përkatësia dhe feja. Socializmi, si koncept aktiv, mund të ketë kolapsuar prej kohësh, por ideja e shkatërrimit të identitetit kombëtar dhe fesë për të krijuar një fushë loje horizontale, është ende shumë e gjallë. Kjo ide iu komunikua në mënyrë të qartë Sër David Frostit në një intervistë nga ish kryeministri i Izraelit, Shimon Peres. Përballë pyetjes në lidhje me burimin e antisemitizmit, Peres u përgjigj se e njëjta pyetje ka torturuar masat hebreje për të paktën dyqind vitet e fundit, duke lënë kështu vend për dy këndvështrime të ndryshme.

Një përgjigje ishte: "Meqë bota është në gabim, ne duhet të ndryshojmë botën". Dhe përgjigja tjetër ishte: "Meqë ne jemi në gabim, duhet të ndryshojmë veten tonë". Për shembull, hebrenjtë që u bënë komunistë, bënë që bota të ndryshonte, bota e urrejtjes. "*Le të ndërtojmë një botë pa kombe, pa klasa, pa fe, një botë pa një Zot që kërkon urrejtjen e njerëzve*"[49].

Zhan Pol Sartrë, autori ekzistencialist, që ishte hebre nga e ëma, diskutonte në të njëjtat linja: arsyeja duhet të zëvendësojë fenë dhe kjo është zgjidhja themelore e shqetësimeve jetike. Për Sartrin,

vazhdimësia e fesë donte të thoshte persekutim kronik i hebrenjve dhe eliminimi i saj u bë pika kyçe në pakësimin e antisemitizmit. [50]

Ndërsa po lexoja me vëmendje një broshurë të titulluar “Përballjet e mëdha në historinë e hebrenjve”, ndesha në një seminar të quajtur “Modernizmi dhe hebraizmi”[51] i mbajtur nga dr. Hertzberg, rabin dhe asistent profesor i Historisë në Universitetin e Kolumbias[52]. Duke vëzhguar qëndrimet e mendimtarëve të shquar hebrej rreth fesë së tyre, Hertzberg përqendrohet më dukshëm tek Marksii dhe Zigmund Frojdi. Marksii i ri atij i duket sikur i ka parë hebrenjtë në *Die Judenfrage* si proto-kapitalist, një viktimë e tensioneve të pafund të kurdisura nga sistemet monetare dhe makineria ekonomike. Për të zgjidhur çështjen hebreje duheshin shkatërruar hierarkitë ekonomike dhe klasore, duheshin emancipuar të krishterët dhe po ashtu hebrenjtë, duke përmbysur praktikat tradicionale të kapitalizmit. Frojdi nga ana tjetër, e shihte fenë si një obsesion i fëmijërisë me figura autoritare, pra në thelb, si një sëmundje, që çdo njeri duhet ta kapërcejë për të arritur shëndet të mirë mendor dhe pjekuri.[53]

Qëndrimi ikonathyes, kjo dëshirë e ngutshme, rebele, për të thyer normat historike, nuk mbeti e kufizuar vetëm tek Marksii dhe Frojdi. Kokat e mëdha të mendimit hebre e përqaftuan me radhë këtë qëndrim. Përse? Herzberg e sheh këtë si një thirrje për çlirim: duke ndarë hebrenjtë nga çdo element i të shkuarës së tyre në Europën mesjetare, ata do të mund të nisnin nga fillimi nga një pozitë të njëjtë me xhentilët. Kjo gjë, shpreh ai, ishte fillimi i modernitetit të hebrenjve. Që të hidhnin rrënjët fuqishëm në kulturën perëndimore, duhej propozuar e shkuara e Europës, ashtu siç ishte, e ngarkuar me mitologjinë dhe bestytnitë e krishtera, në mënyrë të tillë që të gjithë njerëzit, që dilnin nga pluhuri i kësaj historie të zhuritur, të mund të punonin bashkë si partnerë të erës së re[54].

Në diskutimin e Hertzbergut, ky hebre i reformuar, antinacionalist, pro-universalist, nuk është dhe aq i ndryshëm nga nacionalisti bashkëkohor që krenohet duke qenë sionist. Ndërkohë që të dy sillen në mënyrë të kundërt, ata konkurrojnë për të njëjtën gjë. Për hebrenjtë e reformuar të shekullit të 19-të, feja ishte hallka që ata duhej të shkatërronin për të fituar barazinë. Po kështu, Sionizmi i sotëm pohon që feja nuk është më e përshtatshme si forcë unifikuese.

Përveç fraksionit fetar, pjesa më e madhe e sionistëve, politikisht dhe kulturalisht, janë sekularistë, të cilët fillojnë me supozimin se feja hebreje nuk mund të shërbejë më si bazë për bashkimin e hebrenjve dhe se, si rrjedhim, politika për mbijetesën e hebrenjve duhet të gjendet në ndonjë premisë tjetër...Urdhëresa më e madhe nuk është më martirizimi për hir të shenjtërimit të Emrit Hyjnor, por të luftosh për rindërtimin e tokës[55].

Ajo që duket se thonë Peres, Hertzberg, Sartri, Marksii, Frojdi dhe të tjerë, është që inteligjenca hebreje kërkon një shoqëri globale në të cilën mungon Zoti, feja dhe historia, tërësisht e kundërta me pohimin e hebrenjve, që e drejta e tyre ndaj Palestinës bazohet në premtimin e Jehuas[56]. Dëshira e tyre për t'u integruar në një shoqëri edhe më të gjerë nevojite fshirjen e historisë dhe krijimin e një zëvendësueseje. Për këtë, Velhauzen dhe të tjerë ndërmorën detyrën e copëtimit të integritetit të Dhiatës së Vjetër, duke i hapur kështu rrugën mësymjes së Dhiatës së Re dhe që këndeje Kur'anit.

Në vitet e acartë të Luftës së Dytë Botërore, hebrenjtë padyshim që mbajtën mbi supet e tyre tragjedinë dhe vuajtjet, që përgjakën njerëzimin. Me t'ua njohur vuajtjet, armiqtë fitimtarë vendosën t'i kompensojnë ata me anë të një dhurate bujare: “atdheu” i tyre tashmë do ishte në një tokë, që nuk i përkiste as njëres palë e as tjetrës dhe ky proces detyronte miliona banorë të kësaj toke të durojnë ekzistencën mjerrane të një refugjati. Që atëherë, përpjekjet për të sekularizuar Krishterimin dhe

Hebraizmin, për t'i konvertuar ato në simbole të thjeshtë, që pak kanë rëndësi për jetën e përditshme, kanë bërë hapa përpara. Por, të hiqje Zotin, fenë dhe historinë nga mendjet e myslimanëve, rezultoi të ishte një sfidë edhe më e madhe: edhe aty ku sekularizmi depërtoi, myslimanët nuk mundën të tolerojnë Izraelin. Suksesi në këtë fushë tani, do të thoshte të provoje, që të gjitha referencat ndaj hebrenjve apo Palestinës në tekste islame, ishin mashtrime të qarta[57], si dhe të ndiqej shembulli i Dhiatës së Re[58] për pastrimin e Kur'anit nga të gjitha pjesët që perceptoheshin si antisemite.

Përsa kohë që myslimanët mbahen pas Kur'anit, si Fjala e patjetërsueshme e Allahut, çështja e këtij pastrimi mbetet larg arritjeve të tyre. Në lidhje me këtë, Vansbruh u mundua të 'provonte' se Kur'ani i tanishëm nuk është "punë e vetëm dorës së Muhamedit", por në fakt e shumë komuniteteve të shpërndara në botën myslimane, të cilët e zhvilluan tekstin përgjatë një periudhe dyqind vjeçare[59]. *Humphrey* thotë që:

Vansbruh shpreson të arrijë dy pika kryesore:

- Shkrimet islame (jo vetëm hadithet, por vetë Kur'ani) u gjeneruan gjatë një periudhe polemike sektariane, që zgjati më shumë se dy shekuj, dhe që më pas u projektua në mënyrë fiktive në një pikë origjine të shpikur arabe.
- Kjo doktrinë islame, dhe madje dhe figura e Muhamedit, u modeluan sipas prototipit të rabinit hebre.[60]

Kësaj ne mund t'i bashkëngjitem veprat bashkëkohore të Jehuda Nevo dhe J. Koren, të cilat aplikojnë përqasjen e tyre revizioniste ndaj studimeve islame me rezultatet nga më befasueset. Duke përshkruar ekspertizat arkeologjike të Jordanisë dhe Gadishullit Arabik, ato thonë që, edhe pse janë zbuluar punime helene, nabatease, romane dhe bizantine, nuk ka shenja të një kulture arabe lokale në shekujt e 6-të dhe 7-të e.j..

Veçanërisht, nuk janë gjetur kulte paganësh xhahilë të shekullit të gjashtë apo të shtatë në pjesën e Hixhazit (Arabia perëndimore), as fatore paganësh, siç përshkruajnë burimet islame, madje në asnjë zonë tjetër të vëzhguar... Për më tepër, veprat arkeologjike nuk kanë zbuluar gjurmë të vendosjes së hebrenjve në Medinë, Xhejber apo Uedi el-Kurra'. Këto pika janë në kontrast direkt me përshkrimet e burimeve letrare myslimane mbi përbërjen demografike të Hixhazit paraislamik[61].

Koren dhe Nevo pohojnë që, në të vërtetë prova të shumta mbi paganizmin ekzistojnë në Negevin qendror (Palestina jugore), një sipërfaqe kjo e shpërfillur nga burimet islame. Reliket e zbuluara tregonin që aty paganizmi praktikohet akoma deri në fillim të mbretërimit abasit (mesi i shekullit të tetë e.j.), gjë që do të thoshte se një pjesë e konsiderueshme e rajonit të Negev-it ruante identitetin e tij pagan përgjatë 150 viteve të para të Islamit. Këto relike dhe topografia rrethuese, janë shumë të ngjashme (pretendojnë ato) me përshkrimet e vendeve pagane të Hexhazi siç citohet në burimet myslimane.

Si rrjedhim, provat arkeologjike tregojnë që vendet e kultit pagan të përshkruara në burimet myslimane nuk ekzistonin në Hixhaz, por këto vende kulti i ngjanin fort atyre që ndodheshin në Negevin qendror deri kur abasidët erdhën në pushtet. Kjo nga ana tjetër sugjeron që të dhënat mbi fenë xhahile në Hixhaz mund të jenë shëmbëllime të një paganizmi, që aktualisht njihej nga vende të tjera, të largëta.[62]

Nëse e pranojmë pohimin e Koren dhe Nevo, që nuk ka prova mbi qëndrimin e hebrenjve në Hexhaz

gjatë kohës së Profetit, rezultati logjik do të ishte mohimi i të gjitha verseteve, që kishin të bënin me hebrejtë, meqë ata nuk mund të kenë pasur për 'autor' Muhamedin. Si rrjedhim, komuniteti mysliman duhet t'i ketë shtuar ato në një fazë të mëvonë dhe të ketë pranuar që janë pjesë e Kur'anit. Që të kthehet Libri në gjendjen e tij të mëparshme (siç, mesa dukej, kishte shkruar Muhamedi) kërkonte të hiqeshin menjëherë këto pasazhe mashtruese antisemite. Dhe, nëse ne besojmë se paganizmi paraislamik, i cituar në Kur'an dhe sunet, është thjesht një shëmbëlltje e një kulture që lulëzoi në Palestinën jugore, atëherë si rrjedhim, bëhet e diskutueshme vetë figura e Muhamedit. Ky shëmbëllim i mbetjeve antike të pranisë rabine në Palestinë bëri që vërejtjet e Koren dhe Navo të ishin përsosmërisht të përshtatshme me teorinë e Vansbruhut. Në këtë mënyrë, myslimanët ia kishin borxh Hebraizmit këtë bazë të rremë të identitetit të tyre dhe origjinave historike, gjë që shërbente si një arsye më shumë për eliminimin e të gjitha verseteve, që kishin të bënin me hebrejtë.

5. Përfundim

Shumë shteteve myslimane rreth e rrotull Izraelit u është bërë të kuptojnë urgjencën e ndryshimit të programit të tyre shkollor, për të eliminuar çdo pikë që nxit pasione, që janë të papranueshme për hebrejtë[63]. Por Kur'ani mbetet sërish pengesë, libër ky që vazhdimisht citon papranueshmërinë dhe mosbindjen e hebregjeve dhe ajetet e së cilit vazhdimisht njomin buzët e nxënësve të shkollave, të ligjëratave në xhami, të besimtarit pendestar natën vonë me mus'hafin e tij dhe pothuajse në çdo aspekt të jetës së përditshme. Të kuptosh qëllimet që udhëheqin kërkimet e sotme mbi Kur'anin është një detyrim, me qëllim që produktet e këtyre kërkimeve të mos mund ta zënë të papërgatitur lexuesin.

Kërkimet e Shtrugnel dhe Delizsh mbi motivet hebregje tani konsiderohen të ndaluara, për shkak të thënies antisemite. Departamenti i Antikiteteve të Izraelit gjykon në bazë të përshtatshmërisë me vizionin e vet ideologjik. E akoma, çdo i krishterë, hebreg apo ateist, që përfshihet qëllimisht në gënjeshtër për të minuar normat, elegancën, historinë dhe perspektivat e ardhme të Islamit, është i lejuar ta quajë veten shejh, për të besuar që myslimanët i janë mirënjohës objektivitetit të tij dhe të detyruar për të pranuar gjetjet e tij. Kjo nuk mund të pranohet. Pse shkarkimet akademike që lëshojnë ata kundër antisemitëve[64] nuk aplikohen ndaj atyre që shtrembërojnë Islamin për përfitime të tjera? Pse jomyslimanët duhet të jenë autoritete të mendimit me përjashtim të myslimanëve praktikantë? Pse burrat e Kishës, Mingana, *Guillaume*, Vat, Anderson, *Lammans* dhe një hordhi e tërë, që nuk dëshiron ndonjë gjë tjetër më shumë në zemër, sesa të shohë që feja e vet eklipson atë Islame, të konsiderohen si standard i 'paanshëm' i kërkimit shkencor islamik? Pse duhet që *Muri* të konsiderohet autoritet i jetës së Profetit, kur ai shkruan që Kur'ani është ndër "armiqtë më kokëfortë të Qytetërimit, Lirisë dhe të Vërtetës, që ka njohur ndonjëherë bota"?[65]

[*] Muhammad Mustafa Al-Azami, është një prej dijetareve të shquar të hadithit. Lindur në qytetin Mau të Indisë, në fillim të viteve 1930, edukimin fillestarë e ka marrë në Dar el-Ulum Deoband, Indi (1952). Më pas mori gradën magjistër në fakultetin e Ezherit (1955), për të vazhduar më pas me përfundimin e doktoraturës në Universitetin e Kembrixhit (1966).

Përktheu: Edlira Nepravishta

[1] Jam informuar nga një koleg, që dr. Uedad el-Kadi ka deklaruar se dijetarët myslimanë janë të papërshtatshëm për t'u përfshirë në ndonjë punë kërkimore mbi Kur'anin, si pasojë e fesë së tyre. Kjo është tepër befasisëse. Pak vite më parë ajo paraqiti një artikull, ku pohonte, se dijetarët myslimanë duhet të pranojnë autoritetin e kërkimit shkencor perëndimor mbi Islamin. Sipas saj, mungesa e tyre e besimit në fenë Islame ishte padyshim një plus ndaj kredencialeve të tyre. Kohët e fundit ajo ka

pranuar pozicionin e redaktores së asocuar për *Enciklopedinë e Kur'anit* të Brill.

[2] *John Bright*, "Autoriteti i Dhiatës së Vjetër", Sh. Bot. Abington, NAshville, 1967, f. 65-66.

[3] Po aty, f. 66, citon Fridrish Delizsh, "*Die Grosse Täuschung*"(1920)

[4] Po aty, f. 67, fusnota 21.

[5] Po aty, f. 65.

[6] H. Shanks, "Kryeredaktori i përjashtuar i dorëshkrimeve tregon çështjen e tij: një intervistë me John Strugnell", Përmbledhja arkeologjike biblike, qershor-gusht '94, vëll. 20, nr. 4, f. 41-42.

[7] Po aty, f. 43. Një pohim interesant që ai bën është se "Kryepeshkopi kardinal i Parisit është hebre dhe se ai shkon shumë mirë me arkidioqezën e tij, që nuk është hebreje"

[8] Hershel Shanks, "Studiuesit, dorëshkrimet, sekretet dhe 'krimet'", Nju Jork Tajms, 7 shtator 1991, e shfaqur si figurë 18 në *Eisenman* dhe *Robinson*

[9] "Botim i rikopjuar i Dorëshkrimeve të Detit të Vdekur", f. xxi.

[10] Po aty, f. xxii.

[11] Po aty, f. xxiii

[12] Po aty, f. xxiv

[13] Po aty, f. xiv.

[14] Vini re që të gjitha citimet e mëparshme janë nga botimi i parë. Ato janë pranuar dhe në botimin e dytë (dhe ka të ngjarë të pranohen dhe në të tjerat). Shoqata Arkeologjike Biblike ka botuar me sukses "Botimi i Dorëshkrimeve të Detit të Vdekur" në vitin 1991, mes shumë lëvdatave (si dhe dënimit të hidhur të redaktorëve të Dorëshkrimeve). Ishte e tmerrshme kur zbulova që në botimin e dytë, parathënia origjinale prej 36 faqesh e Hershel Shanks ishte reduktuar në vetëm dy. Nuk jepej asnjë shënim për këtë fakt.

[15] H. Shanks, "Studiuesi pohon që historia palestineze është shtypur në favor të izraelitëve", Përmbledhje e Arkeologjisë Biblike, mars-prill '96, vëll. 22, nr. 2, f. 54. "Artikulli i Whitelam u konsiderua aq i rëndësishëm saqë u shpërnda në një nga pak sesionet e sponsorizuara nga Shoqata e Letërsisë Biblike bashkë me Akademinë Amerikane të Fesë dhe Shkollat Amerikane të Kërkimit Oriental" (po aty, f. 54).

[16] Po aty, f. 56.

[17] Po aty, f. 56, citohet Keith Whitelam

[18] Po aty, f. 69

[19] Jozef Shaht, "Origjinat e jurisprudencës muhamedane", botimi i dytë, Sht. Bot. Oxford Univ., 1959, Parathënia.

[20] Shih "El-Mishkat mujore", Ismail el-Uthmani, Uajdah, Marok, viii, 1419h, f. 28-29.

[21] Eduard Said, "Shpjegim i Islamit" *Pantheon Books*, Nju Jork , 1981, f. xvii.

[22] H. Reland, "Katër traktate në lidhje me doktrinën, disiplinën dhe adhurimin e mahometanëve", Londër, 1712, f. 5-6.

[23] Po aty, f. 6-7.

[24] Po aty, f. 7-8.

[25] Po aty, f. 12

[26] Shih përkufizimin e Jehuda Nevo mbi Revizionizmin në po këtë vepër, f. 7-8.

[27] Shih, për shembull, qëndrimin apologjistik që gjendet në artikujt e Jozef Blenkinsop dhe Barklei Njuman (Përmbledhje e Biblës, vëll. xii, nr. 5, tetor 1996, f. 42-43

[28] Këtu gjenden disa nga akuzat e ngritura kundër myslimanëve nga dijetarët e krishterë të shekullit të 17-të dhe 18-të të shkruara në latinisht: (1) Myslimanët adhurojnë Afërditën, (2) Ata adhurojnë të gjitha krijesat, (3) Mohojnë ekzistencën e Ferrit, (4) Besojnë që mëkatet fshihen thjesht duke larë trupin, (5) Besojnë që djajtë janë miq të Zotit dhe të profetit Muhamed, (6) Besojnë që të gjithë djajtë do të shpëtojnë, (7) Dhe besojnë se gratë nuk do të hyjnë në Parajsë, (8) Dhe besojnë se Maria e krijoi Jezusin thjesht duke ngrënë hurma, (9) Besojnë në Moisiu është ndër të mallkuarit [shih "Katër traktate" të Riland, f. 47-102].

[29] Eduard Said, "Shpjegimi i Islamit", f. xii.

[30] Po aty, f. xv.

[31] Po aty, f. 4-5.

[32] Po aty, f. 5.

[33] Po aty, f. 23

[34] Po aty, f. 23.

[35] Po aty, f. xvii, 23.

[36] Një praktikë që vazhdon edhe sot.

[37] Një shembull i shpejtë e kësaj është një artikull i vitit 1805 në "Regjistrin Vjetor Aziatik" nga *J. Gilchrist*, të titulluar "Vëzhgim i politikave të formimit të një strukture orientale, me qëllim furnizimin e rregullt të agentëve diplomatikë, interpretuesve, etj, për lehtësimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta mes Britanisë së Madhe dhe kombeve aziatikë, imitim ky i një instituti të ngjashëm në

Francë”. [Shih W.H. Behn, *Index Islamicus: 1665-1905, Adiyok, Millersville PA, 1989, f. 1*]

[38] Përpyqjet e orientalistëve për të eliminuar pacenueshmërinë e Kur’anit, kanë gjetur disi mbështetje nga një pjesë e elitës sekulariste turke. Presidenti Demirel madje në një regjistrim u shpreh me një thënie kontradiktore se Islami bashkëkohor është tërësisht i përputhshëm me sekularizimin, duke shtuar madje pa aspak finesë se 330 versete nga Kur’ani “nuk janë më të praktikueshme” dhe duhet të hiqen. Presidenti 76 vjeçar u detyrua të përballlej me furinë publike dhe gazetareske pas thëniesve të tij, ndërkohë që oferta e tij për të organizuar një “reformë fetare” u refuzua nga Gjykata e lartë e Çështjeve Islame në Turqi.

[39] R. S. Humphreys, “Historia e Islamit”, f. 83.

[40] H. A. R. Gibb, “Gazeta e legjislacionit krahasues dhe ligjit ndërkombëtar”, seria e 3-të, vëll. 34, pjesët 3-4 (1951), f. 114.

[41] Humphreys është profesori i mbretit Abdul Aziz i Studimeve Islame në Universitetin e Kalifornisë, Santa Barbara. Për këtë citim referojuni librit të tij “Historia Islame”, f. 84. Shih gjithashtu J. Esposito, “Islami, rruga e drejtë”, Sht. Bot. Oxford Univ, Nju Jork, 1991, f. 81-82.

[42] Sikurse M. M. el-A’zami, “Mbi veprën Origjinat e Jurisprudencës Muhamedane të Shahtit”, John Wiley, 1985.

[43] Shih Mustafa es-Sibai, “es-Sunna ue Mekanetuha”, Kairo, 1961, f. 27.

[44] Vansbruh, “Studime kuranore”, f. 44.

[45] Denis Fishman, “Diskutimi politik tek Eksodi: Karl Marksi dhe çështja hebreje”, Sht. Bot. University of Massachusetts, 1991, f. 26.

[46] Po aty, f. 28.

[47] Po aty, f. 7, 15.

[48] Po aty, f. 13.

[49] “Të flasësh me David Frost: Shimon Peres”, transmetuar në Sh. B.A në Sistemin e Shpërndarjes Publike (PBS), 29 mars 1996, Transkript nr.53, f. 5.

[50] M. Kutb, “el-Mustashrikun ue el-Islam”, Maktabat Uahba, Kairo, 1999, f. 309. Kjo ide gjendet në veprën e Sartrit “Antisemitët dhe hebrenjtë” Schocken Books Inc., Nju Jork, 1995.

[51] Kjo është një antologji leksionesh të botuara nga Departamenti i Historisë, Universiteti i Denverit, e redaktuar nga Stenlei M. Vagner dhe Alen D. Brek.

[52] Ky është një rabin në Temple Emanuel, Nju Xhersei. Përveç rolit të tij si rabin, ai ka dhënë mësim në Universitetet Rutgers, Princeton dhe atë hebre në Jeruzalem.

[53] Vagner dhe Brek, “Përballje të mëdha në historinë hebreje”, f. 127-128.

[54] Po aty, f. 128-129.

[55] Po aty, f. 131.

[56] Meqë, sipas fjalëve të rabinit Hertzberg, shumica e sionistëve nuk besonin më në Hebraizëm si faktor unifikues, ata kërkojnë të gjejnë një nocion sekularizues të “rindërtimit të tokës” për të përmbushur nevojat e tyre.

[57] Pak pas krijimit të shtetit të Izraelit, rev. prof. Guillaume ‘provoi’ që el-Mesxhid el-Aksa, me të cilën myslimanët ishin aq të lidhur, në të vërtetë ndodhej në një fshat të vogël në periferi të Mekës, shumë larg Jerusalemit! [A. *Guillaume*, “Ku ishte el-Mesxhid el-Aksa”, *el-Andalus*, Madrid, 1953, f. 323-326].

[58] Shih “Bibla e shenjtë, versioni bashkëkohor në anglisht”, Shoqata Amerikane e Biblës, Nju Jork, 1995. Jozef Blenkinsop “Versioni bashkëkohor në anglisht: përkthimi i pakujdesshëm tenton të zbusë ndjenjat anti-hebreje”, Përmbledhje e Biblës, vëll. xii, nr. 5, tetor 1996, f. 42. Po në të njëjtin numër: Barklei Njuman, “Përkthyesi i versionit bashkëkohor në anglisht: Ishim besnikë ndaj qëllimit të tekstit”, po aty, f. 43. Zgjerimi i këtyre ndryshimeve është shumë më i madh se ç’thonë këto artikuj. Për shembuj të tjerë mund t’i referoheni diskutimit të plotë të kësaj vepre, f. 291-294.

[59] Prof. Norman Kalder iu bashkua më vonë kësaj bande, duke treguar që veprat letrare të asaj kohe, dhe jo vetëm Kur’ani, kishin për autorë komunitetin mysliman si të tërë. Ai gjithashtu teorizoi që veprat e famshme letrare dijetarëve të shekujve të 2-të dhe të 3-të, si Muuatta e Imam Malik, el-Mudauana e Sahnun, el-Um e Shafiut, el-Kharaxh e Ebu Jusufit e me radhë, ishin tekste shkollore të paautorizuara nga një person i vetëm [Norman Kalder, “Studimet e Jurisprudencës së hershme islame”, Sht. Bot. Oxford Univ., 1993].

[60] *R.S. Humphreys*, “Historia e Islamit”, f. 84.

[61] J. Koren dhe J. D. Nevo, “Përqasjet metodologjike ndaj studimeve islame”, *Der Islam*, Band 68, Heft 1, 1991, f. 101.

[62] Po aty, f. 102.

[63] Në lidhje me këtë, në bazë të informacionit nga Jordania, Izraeli i kërkoi kohët e fundit disa prej shteteve të tij fqinje (si pjesë e paketës së procesit të paqes), të eliminojnë të gjitha referencat e programeve shkollore në lidhje me kryqëzatat, Salahudin el-Ejjubi (Saladini) dhe rimarrjen e tij të Kudsit (Jerusalemit).

[64] Vetë termi ‘antisemit’ është një keqpërfaqsim i qëllimtë për anti-hebre, meqë pjesa më e madhe e semitëve gjatë 14 shekujve të fundit, kanë qenë myslimanë!

[65] Citohet në M. Brumholl, “Islami në Kinë”, Londër, 1987, f. 2.

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi